



**ANALIZË POLITIKE**

**Nr. 4/13 - QERSHOR 2013**

# **ZBATIMI I MARRËVESHJES SË DIALOGUT POLITIK KOSOVË-SERBI**

Ky projekt mbështetet nga: Ambasada Britanike në Prishtinë



British Embassy  
Pristina

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përgatitën: Ilir Deda dhe Ariana Qosaj-Mustafa

Të drejtat autoriale © 2013 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjete elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) ose +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rr. "Rexhep Mala" Nr 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel dhe Fax: +381 38 227 778

[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## Përmbajtja

I.	Hyrje.....	4
II.	Kërkesat e Këshillit të BE-së (Dhjetor 2012) .....	5
III.	Konkludimet e Dialogut Politik /Marrëveshjet dhe Zbatimi.....	6
	Marrëveshja: Grupi Punues për Sudimin e Fizibilitetit të magjistrales Prishtinë-Nish: .....	6
	Marrëveshje: Shkëmbimi i Oficerëve për Ndërlidhje / Njësia speciale multietnike e Policisë së Kosovës në mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare Serbe /:.....	7
	Marrëveshja: Fondi Special për Kosovën Veriore:.....	8
	Marrëveshja: Marrëveshja e Parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve: .....	9
	Marrëveshja: Plani i Zbatimit: .....	9
	a) Përshtatja e Kornizës Ligjore: .....	10
	c) Policia:.....	11
	d) Drejtësia:.....	12
	e) Ligji mbi Amensti:.....	13
	f) Zgjedhjet Komunale:.....	13
IV.	Rruga Përpara .....	13
	ANEKS - Zbatimi i marrëveshjeve teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë .....	16

## I. Hyrje

Ky raport fokusohet në analizën e zbatimit të marrëveshjes e cila është rrjedhojë e dialogut politik të Kosovës dhe Serbisë, në nivel të Kryeministrave dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit European (BE). Raporti vështron hapat e ndërmarrë nga institucionet e Kosovës drejt zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri tani.

Më 28 qershor 2013, Këshilli Evropian vendosi që më së largu deri në janar të vitit 2014 të hapë bisedimet me Serbinë për pranimin e saj, varësisht prej zbatimit të plotë të marrëveshjes së arritur me Kosovën në prill të vitit 2013 dhe autorizoi hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën.<sup>1</sup> BE-ja, me këtë, shpërbleu Kosovën dhe Serbinë për hapat që të dyja kanë ndërmarrë drejt "normalizimit" të marrëdhënieve të tyre. Prishtina dhe Beogradi, me mbështetjen e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), ngritën dialogun e tyre teknik në atë të nivelit politik, pasi që mos-zbatimet e disa marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut teknik dhe çështjes së veriut mbetën të pazgjidhura. BE-ja, nëpërmjet Zyres së Përfaqësuesit të Lartë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë, Kethrin Eshton, u bë nxitës dhe moderator i dialogut. Takimet vazhduan të mbahen në Bruksel, në ambientet e Selisë kryesore. Roli i "moderatorit" u konsiderua i nevojshëm në mënyrë që të mbahej në vazhdimësi procesi si dhe që të sigurohej, nëpërmjet politikës së tipit "karrotë e shkop" të BE-së, se çdo gjë që bihet në dakord gjatë procesit – të zbatohet me të vërtetë në terren. Duke pasur parasysh peshën që ka anëtarësimi në BE, Brukseli filloi që në dialog të përmendë përparimin duke e cilësuar atë si "çelësi i portës" sa i përket progresit të të dy vendeve drejt anëtarësimit në BE. Kjo qasje është përdorur edhe që ajo të forcojë rolin e vet si garantuese e marrëveshjeve, duke bindur palët e dialogut që të arrijnë konsensus dhe të zbatojnë marrëveshjet nëse ata duan të çojnë përpara procesin drejt pranimit të tyre në BE.

Në Kosovë është pritur se dialogu do të rezultonte me një dokument mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë – dis zyrtarë të Qeverisë së Kosovës e kanë quajtur edhe si "traktat paqeje" mes dy shteteve. Përkundrazi, marrëveshja e parë solli në Kosovë riaranzhime të brendshme. Zyrtarë qeveritarë të Kosovës keq-informuan opinionin publik me komunikim publik shumë të dobët e me mungesë transparence, me deklarime të pavërteta publike dhe me një lloj qëndrimi mbrojtës. Zyrtarët politikë përdorën retorikë të rëndë për të bindur publikun se ata "kurrë" më nuk do të angazhohen në dialog politik me Serbinë, se kurrë më nuk do të bisedojnë për veriun e Kosovës, dhe se kurrë më nuk do të pranojnë çfarëdo riaranzhimi të brendshëm.

Në mënyrë që të forcojë këtë pozicion mohues, Kuvendi i Kosovës miratoi më 18 tetor 2012 "Rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" në mbështetje të dialogut, dhe e cila thekson se rezultatet e dialogut duhet të jenë në pajtueshmëri me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rendin e brendshëm kushtetues të Kosovës. Gjithashtu, rezoluta deklaronte se marrëveshjet e arritura në dialogun politik duhet të ratifikohen në Kuvendin e Kosovës. Kjo rezolutë u shkel menjëherë, duke ulur më tej besimin e publikut kosovar për rezultatet e dialogut. Kuvendi i Kosovës ka votuar gjithsejt dy Rezoluta dhe tre

---

<sup>1</sup> Konkludimet e 27/28 qershorit 2013 të Këshillit European, shih: [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_Data/docs/pressdata/en/ec/137634.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/ec/137634.pdf)

mocione kontradiktore mbi të njëjtën.<sup>2</sup> Po që se kjo do të duhej respektuohet nga Qeveria e Kosovës, dialogu nuk do të mund të prodhonte rezultate të mëtutjeshme.

Më 19 prill 2013 Kosova dhe Serbia u pajtuan në “Marrëveshjen e Parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve”, e cila u cilësua si historike. Në maj 2013, kosovarët u anketuan se si ndihen rreth ‘Marrëveshjes Thaçi-Daçiq’ që u bë në prill me ndërmjetësimin e Bashkimit Europian. Të anketuarit shqiptarë të Kosovës ishin të ndrë – 43% mbështetnin marrëveshjen, 38% e kundërshtonin atë. Një pjesë prej 19% nuk dinin ç’mendim kishin apo nuk dhanë përgjigje.<sup>3</sup> Serbët e Kosovës ishin më pak mbështetës ndaj marrëveshjes – ata që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës kryesisht kundërshtonin marrëveshjen, ndërsa ata në jug të lumit Ibër kryesisht e mbështetnin atë. Vetëm 21% të kosovarëve mendojnë se marrëveshja është më shumë në favor të Kosovës, e rreth 30% thonë se Serbia do të përfitojë, 37% i shohin të dyja vendet si përfituese nga marrëveshja, ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve nuk kishte ndonjë mendim. “Marrëveshja e parë” u ratifikua në Kuvendin e Kosovës më 27 qershor 2013, ku nga 120 deputetë 84 votuan pro, 3 kundër dhe 1 abstenoj.

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë e ka devijuar fokusin që zhvillimi i politikave publike duhet të ketë në problemet më të rënda të Kosovës, sikurse gjendja e mjeruar e ekonomisë, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, arsimi dhe shëndetësia. Këto janë çështje të politikave të cilat kanë rënë në errësirë shkaku i vëmendjes e cila ka zënë titujt kryesorë të mediave dhe e cila është renditur si një prej çështjeve kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova.

## II. Kërkesat e Këshillit të BE-së (Dhjetor 2012)

Në dhjetor 2012, Këshilli i BE-së në konkluzionet e saja ka deklaruar se Kosova dhe Serbia duhet të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre, si një prej kriterëve të rëndësishme në rrugën drejt integritimit në BE, duke mos bllokuar njëra-tjetrën në përpjekjet e tyre. Një pjesë e kësaj është edhe zbatimi në mirëbesim i të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog.<sup>4</sup>

Kushtëzimet e BE-së për rezultate në dialogun politik u nënvizuan në konkluzionet e Këshillit të BE-së më 11 dhjetor 2012, ku nga Serbia u kërkuar që: (1) të shpërbëjë institucionet e paligjshme gjyqësore dhe policore në veri të Kosovës, (2) t’i bëjë transparente fundet e sponsorimit të institucioneve të saj në Kosovë, dhe (3) nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me EULEX-in, të sigurojë se misioni i EULEX-it

---

<sup>2</sup> Më 10 mars 2011 Kuvendi miratoi Rezolutën për dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, duke mbështetur dialogun për çështje "praktike" dhe duke e ngushtuar dialogun në vetëm "çështje teknike". Rezoluta e dytë për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë u miratua më 18 tetor 2012, duke i dhënë dritën e gjelbër takimit në Bruksel mes kryeministrit Thaçi dhe homologut të tij serb ditën në vijim. Kuvendi votoi gjithashtu mocionet kontradiktore mbi dialogun. Më 7 dhjetor 2011 opozitarët LDK, Vetëvendosje dhe AAK votuan mocionin për reciprocitet të plotë politik, ekonomik dhe tregtar me Serbinë në tërë Kosovën, e cila pot ë zbatohet, i jepte fund dialogut. Ky mocion u zëvendësua më 20 janar 2012 nga një mocion i ri i mbështetur nga partitë në pushtet të cilët rifilluan dialogun. Më 10 maj 2012, Kuvendi votoi për katër rekomandimet mbi personat e zhdukur duke kërkuar që Qeveria e Kosovës të kushtëzojë bisedimet e mëtejshme me Serbinë përmes zbardhjes së fatit të personave të zhdukur. Shih Raportin e KIPRED-it "Analiza e zbatimit të marrëveshjeve teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë", (2013).

<sup>3</sup> Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, “Barometri i Sigurisë në Kosovë – Zërat e Kosovës: Përjetime dhe Perceptime”, 22 maj 2013, fq.11. <http://www.qkss.org/en-us/Reports/Kosovo-Security-Barometer---The-voices-of-Kosovo-Insights-and-Perceptions-157>

<sup>4</sup> Shih Konkluzionet e Këshillit rreth Procesit të Zgjerimit dhe Stabilizim Asociimit, 3210 Mbledhja e Këshillit të Punëve të Përgjithshme në Bruksel tek [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf) faqe 11.

mund të zbatojë plotësisht mandatin e tij në veri, pa ndërhyrjen e Beogradit në synimet e EULEX-it drejt hapjes dhe funksionalizimit të Gjykatës së Mitrovicës. Në anën tjetër, Kosovës i është garantuar që nëpër tërë territorin të ketë një përbërje të vetme institucionale dhe administrative, por Kosova gjithashtu pritet që të zhvillojë planin e shtrirjes në veriun e Kosovës dhe të adresojë “nevojat e veçanta” të popullatës lokale serbe në Kosovën veriore.

Edhe Këshilli i BE-së edhe Komisioni i BE-së synojnë të sigurojnë atë se asnjëra palë, me anë të dialogut politik, nuk mund të bllokojnë njëra-tjetrën në procesin e anëtarësimit evropian, ndërsa i bën Serbisë thirrje në mënyrë eksplicite që të respektojë integritetin territorial të Kosovës.<sup>5</sup> Në mënyrë që të dyja vendet të marrin "karrotën" e radhës, në qershor 2013,<sup>6</sup> "ata duhet të shfaqin përmirësim të dukshëm e të qëndrueshëm të marrëdhënieve", zbatim të plotë të marrëveshjeve të arritura, duke përfshirë edhe marrëveshjet përmbyllëse mbi energjinë (me Serbinë, duke respektuar plotësisht Traktatin e Komunitetit të Energjisë) dhe telekomunikacionin, si dhe të rrisin bashkëpunimin gjithëpërfshirës rajonal. Në mënyrë themelore, Serbia duhet të largojë nga veriu i Kosovës aparatit e saj të sigurisë, të shpërbëjë komunitat paralele, dhe të sigurojë stabilitetin e serbëve të Kosovës në veri.

U kërkua që çmontimi i strukturave të Beogradit në veri të Kosovës të bëhet në mënyrë transparente dhe bashkëpunuese si dhe duke respektuar ato që Këshilli i quajti "nevojat e veçanta të popullatës lokale", në mënyrë që Kosova të ketë një njësi të vetme institucionale dhe administrative dhe të bashkëpunojë me EULEX-in dhe Policinë e Kosovës në veri.<sup>7</sup>

Në konkluzionet e tij, Këshilli i BE-së ka shprehur mbështetjen dhënë dialogut politik mes Kosovës dhe Serbisë, ka përshëndetur progresin e bërë në zbatimin e **MIK**, vendimin për të emëruar personat për ndërlidhje, marrëveshjen lidhur me rrjedhën transparente të parave për komunitetin serb, dhe vendimin e Kosovës për të përmirësuar mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare përmes krijimit të njësisë së veçantë brenda PK-së.<sup>8</sup> Edhe njëherë BE-ja përdori politikën e "karrotës dhe shkopit" për të nxitur dy palët që tani të ecin tutje me të kështuquajturin normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe përmirësimi i marrëdhënieve të ndërsjella që i lidhur për rrugën e të dy vendeve drejt integritetit në BE.

### III. Konkludimet e Dialogut Politik /Marrëveshjet dhe Zbatimi

Gjatë trembëdhjetë raundeve të takimeve mes Kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi dhe Kryeministrit të Serbisë Ivica Daçiç, nga 19 tetori 2012 e deri më 21 qershor 2013, janë arritur gjashtë marrëveshje/përfundime. Lista më poshtë jep vetëm përmbledhje të takimeve që kanë rezultuar me përfundim/marrëveshje. Periudha e monitorimit të zbatimit të Marrëveshjeve ka qenë tetor 2012 – qershor 2013.

- Marrëveshja: Grupi Punues për Sudimin e Fizibilitetit të magjistrales Prishtinë-Nish:

<sup>5</sup> Shih Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit të BE-së 2012-2013:

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/strategy\\_paper\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/strategy_paper_2012_en.pdf)

<sup>6</sup> Nëse arrihet progres substancial, Këshilli i BE-së mund të vendosë në qershor 2013 që t'i miratojë Serbisë datën për bisedimet për praninë; gjersa Kosova mund të fitojë hapjen e bisedimeve për stabilizim asociim.

<sup>7</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf) page 11

<sup>8</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/134234.pdf) page 11

Konkludimet u arritën më 7 nëntor 2012,<sup>9</sup> me pajtim në mes tjerash edhe për mbështetje të vazhdueshme të dy palëve në zbatimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve teknike, duke përfshirë edhe Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Palët po ashtu janë pajtuar që të vazhdojnë punën në përmirësimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore e fetare në Kosovë dhe të krijojnë një grup punes teknik të përbashkët që do të përgatisë studimin e fizibilitetit për magjistralen Nish-Prishtinë.

Zbatimi: Nuk janë krijuar kurrfarë hapash për themelimin e grupit punes të dakorduar për studimin e fizibilitetit të magjstrales Prishtinë-Nish.

- Marrëveshje: Shkëmbimi i Oficerëve për Ndërlidhje / Njësia speciale multietnike e Policisë së Kosovës në mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare Serbe /:

Pikat kryesore të konkluzioneve të arritura më 4 dhjetor 2012,<sup>10</sup> ishin lidhur me këmbimin e Oficerëve Ndërlidhës përkatës të Kosovës dhe Serbisë; identifikimin dhe sigurimin e mënyrave për qarkullimin transparent të parave që shkon në mbështetje të komunitetit serb në Kosovë; krijimi i njësisë speciale të policisë multietnike brenda Policisë së Kosovës që do të ketë përsipër mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore; si dhe vazhdimi i punës në energji dhe telekom në nivel të ekspertëve. Konkluzionet kanë adresuar pjesërisht edhe intensifikimin e bashkëpunimit mes komisioneve përkatëse lidhur me personat e zhdukur.

Zbatimi:

Liaison Officers: Veprimi i parë që ka ngjarë gjatë zbatimit të Marrëveshjes së pare ka ndodhur më 17 qershor 2013, me rastin e zbakimit të Oficerëve Ndërlidhës (ON) në Beograd dhe respektivisht Prishtinë. Vetëm dy ditë pasi filloi misionin e tij si ON i Kosovës në Beograd, ish-Ambasadori i Kosovës në Suedi, Lulzim Peci, ofroi dorëheqjen e tij pranë kryetares së Kosovës, Atifete Jahjaga. Shkaku kryesor ishte në: kritikën që ai ka marrë nga kryeministri i Kosovës pas deklaratave të tij se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë do të arrihet vetëm atëherë kur Serbia dhe Kosova të njohin reciprokisht njëra-tjetrën si shtete sovranë.<sup>11</sup> Ngjashëm, ON i Serbisë për Kosovën, Dejan Paviqeviq deklaroi në Prishtinë se Serbia kurrë nuk do ta njohë Kosovën. Pas dorëheqjes së Pecit, Valdet Sadiku, ish-Ambasadori i Kosovës në Kroaci, u emërua si ON i Kosovës në Serbi më 20 qershor 2013. Çelësi i funksionimit të suksesshëm është në kanalet e hapura të komunikimit mes ON-ëve dhe institucioneve qeveritare të shteteve të ndërsjella nikoqire.

Njësia e veçantë shumë-etnike e Policisë së Kosovës në mbrojtje të trashëgimisë Serbe: Policia e Kosovës në prill 2013 ka krijuar njësinë për Sigurinë e Trashëgimisë Kulturore dhe Objekteve Fetare, me 200 oficerë policorë. Kjo njësi është themeluar në kuadër të Divizionit të Njësive Speciale, përkatësisht në Drejtorinë e Sigurisë së Objekteve dhe Personaliteteve me Rëndësi të Veçantë. Misioni i këtyre 200 anëtarëve të njësisë përfshin sigurinë e pjesës së jashtme të trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare. Njësia punon ngushtë me tre komponente: komunat, stacionet policore dhe prijësit fetarë.

<sup>9</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/133369.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/133369.pdf)

<sup>10</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/134038.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/134038.pdf)

<sup>11</sup> <http://www.koha.net/?page=1,13,149594>

Energjia/Telekomunikacioni: Sa i përket punës në energji dhe telekom, grupet punuese të ekspertëve dështuan në arritje të marrëveshjes. Telecom Serbia kishte propozuar që Kosova të ketë prefiksin e saj telefonik por aplikimi pranë Njësisë Ndërkombëtare të Telekomunikacionit të procesohet nëpërmjet Serbisë. Kosova e kundërshtoi këtë propozim, dhe as nuk pranoi t'i japë Serbisë licencë për kompaninë e saj "Telekom Srbija", për të vepruar si biznes vendor në Kosovë, pasi vetëm kompanitë e regjistruara në vend mund të aplikojnë për licenca të tilla, sipas ligjeve të Kosovës. Përgjigje e ngjashme iu dha Serbisë në kërkesën e saj për energji dhe licencim të një furnizuesi në Kosovë.<sup>12</sup>

Për shkak të mos-arritjes së çfarëdo konkludimi, diskutimet u morën përsipër nga dy Kryeministrat të cilët deri më tash nuk kanë arritur marrëveshje.<sup>13</sup>

- Marrëveshja: Fondi Special për Kosovën Veriore:

Më 17 janar 2013, duke u mbështetur në marrëveshjen për MIK të arritur më 4 dhjetor të 2012, të dy Kryeministrat përkohësisht ranë dakord mbi mënyrat e mbledhjes së detyrimeve doganore, taksave dhe TVSH-së.<sup>14</sup> Konkluzionet e rena dakord erdhën në kohën e zbatimit të mëvonshëm në katër pikat kufitare të marrëveshjes së MIK. Përmes kësaj marrëveshjeje, BE vijon të shohë Kosovën si zonë e vetme doganore, ndërsa serbët e Kosovës në veri do të fillojnë të paguajnë detyrimet doganore, taksat dhe TVSH-në, e në këmbim të kësaj do të kenë Fondin e përbashkët të Serbëve të Kosovës veriore me Qeverinë e Kosovës dhe BE-në për zhvillim ekonomik dhe infrastrukturor të veriut të Kosovës.

Zbatimi: Themelimi i posteve të MIK kërkon që të gjitha mallrat që hyjnë në Kosovë në këtë pjesë t'i nënshtrohen detyrimeve doganore, siç kërkohet nga ligjet e Kosovës, me ç'rast qytetarët serbë të Kosovës kanë refuzuar të pranojnë të paguajnë detyrimet që shkojnë në buxhetin e Kosovës. Zgjidhja për këtë kontest u njoftua se ishte gjetur në takimin mes Kryeministrit të Kosovës dhe Serbisë, të mbajtur më 17 janar 2013 edhe pse detajet e marrëveshjes nuk janë bërë të ditura. Të dy palët, Kosova dhe Serbia, kanë dhënë llogari kontradiktore për atë që është dakorduar.

Si rezultat i marrëveshjes, qeveria e Kosovës propozoi amendamentimin e Ligjit të Buxhetit të Kosovës në vitin 2013 në mënyrë që të zbatohet marrëveshjen. Projektligji u dha paraprakisht në Komitetin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës i cili pritet të miratojë amendamentin e Ligjit për Buxhetin e Kosovës në një takim të planifikuar për 26 qershor 2013. Ndryshimet e propozuara nga qeveria janë shtimi i një paragrafi të ri në Nenin 9, që thotë: "Të gjitha paratë publike të mbledhura nga mallrat e importuara nga bizneset e regjistruara në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, apo që janë të destinuara për konsum në këto komuna, në momentin e hyrjes në Kosovë nëpërmjet pikave doganore në Jarinjë (pika 1) ose Bërnjak (pika 31) do të dërgohen në Fondin e Kosovës të identifikuar dhe të regjistruar në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe i ndarë për Fondin e Zhvillimit të Mirëbesimit i krijuar nga Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, në llogarinë që do të hapet në një bankë tregtare."

Vlerësimet për implikimet buxhetore në zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë vlerësuar të jenë rreth 6 milionë euro, ku 10 milionë euro do të sigurohen nga BE dhe Serbia, gjithsej 16 milionë euro. Ky fond do të menaxhohet nga Zyra e BE në Kosovë, QK, ZSO si dhe me një rol të papërcaktuar të Qeverisë së Serbisë.

<sup>12</sup> <http://www.kosova-sot.info/ekonomi/ska-marreveshje-per-telekom-dhe-energji>

<sup>13</sup> <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,149754>

<sup>14</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/134784.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/134784.pdf)



Në pesë vitet e fundit, KIPRED ka avokuar për Fondin Special i cili do të përfshinte katër komunitat veriore me shumicë serbe dhe Mitrovicën jugore. Kjo do të kishte siguruar një zhvillim të balancuar të rajonit i cili historikisht ka qenë zonë e vetme ekonomike, për shkak të varësisë ndaj minierës së Trepçës. Krahas kësaj, një zgjidhje e tillë do të ishte po ashtu multi-etnike dhe do të shërbente si urë për të ngushtuar ndasinë e thellë etnike në Kosovën veriore. Përjashtimi i Mitrovicës jugore nga ky Fond betonon ndarjen tek ura e Mitrovicës, dhe në vënd se tëkontribujë në zhvillimin në linja tej-etnike ajo veçse do të thellojë më tej ndarjen etnike.

- Marrëveshja: Marrëveshja e Parë mbi Parimet që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve:

Më 19 prill 2013, në takim të dhjetë në mes të kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë, u arrit një marrëveshje 15 pikëshe për vendosjen e parametrave për përfshirjen e veriut të Kosovës brenda kuadrit ligjor të Prishtinës. Marrëveshja krijon Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, i cili do jetë i krijuar nga katër komunitat serbe të veriut të Kosovës. Asociacioni/bashkësia do të merrë garancitë ligjore nga Kosova dhe Serbia dhe një autoritet fillestar qeverisës mbi pesë fusha: zhvillimi ekonomik, shëndetësia, arsimiti, planifikimi urban dhe rural. Kompetenca shtesë mund të delegohen nga Qeveria e Kosovës. Anëtarët e strukturave serbe të sigurisë do të absorbohen në strukturat ekuivalente të Kosovës. Një rajon i ri i definuar meligj i katër komunave veriore do të ketë komandantin e vet rajonal të policisë, ndërkohë që gjykata e shkallës së dytë - Gjykata e Apelit - do të ndahet nëpërmjet krijimit të një paneli të veçantë të gjyqtarëve serbë të Kosovës të cilët do të merren me të gjitha komunitat me shumicë serbe të Kosovës. Zgjedhjet lokale në Kosovë do të organizohen në komunitat veriore në vitin 2013 me ndërmjetësimin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Në fund, me këtë marrëveshje Kosova dhe Serbia zotohen që të mos bllokojnë njëra-tjetrën në rrugën e tyre në BE. Në Marrëveshje, palët janë zotuar për gjetjen e zgjidhjeve mbi energjinë dhe telekomunikacionin deri më 15 qershor 2013, përfshirë edhe planin e implementimit deri më 24 prill 2013.<sup>15</sup> Asnjëri prej afateve përfundimtare nuk janë respektuar.

- Marrëveshja: Plani i Zbatimit:

Më 21 maj 2013, në vënd se me 26 prill sipas Marrëveshjes së Parë, dy Kryeministrat dhe PL Kethrin Eshton sigluan planin e zbatimit mbi parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve.<sup>16</sup> Në kuadër të Planit të Zbatimit, palët u pajtuan që Komisioni i Zbatimit i përbërë nga të dyja palët dhe me lehtësimin e BE-së, do të mbikëqyrë procesin në fushat në vijim: Kosova dhe Serbia do të përshtatin kornizat e tyre ligjore në mënyrë që të zbatojnë marrëveshjen e parë; do të krijojnë një ekip menaxhimi për themelimin e Asociacionit/bashkësisë; do të caktojnë një grup pune për të zhvilluar planet e detajuara dhe afatet kohore për integrimin e personelit të Sigurisë Serbe në strukturat e Kosovës si dhe të emërojnë një ushtrues detyre të Komandantit Rajonal për veriun e Kosovës; do të ngrisin një grup punues të përbërë nga përfaqësues të Serbisë dhe Kosovës për të zhvilluar planin për integrimin e autoriteteve gjyqësore serbe në strukturat ekuivalente të Kosovës, përfshirë zyrat e gjykatave themelore dhe prokurorive publike në pjesën veriore të Kosovës, dhe në fund, Komisioni i Zbatimit do të fillojë diskutimet, dhe me udhëheqjen e OSBE-së dhe grupeve punuese, do të vendosin mbi zgjedhjet komunale në pjesën veriore të Kosovës. Plani i Zbatimit gjithashtu liston afatet kur duhet të përfundojnë ato veprime. Në fund, plani në dispozitat e përgjithshme, specifikon që i gjithë financimi i strukturave paralele nga Serbia në pjesën veriore të Kosovës duhet të vihet në dispozicion të Komisionit të Zbatimit dhe të dyja palët duhet të bien dakord mbi parimet për financim transparent. Përfundimisht, në takim të cili u mbajt më 20

<sup>15</sup><http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2013/04/20/3224318/Originalni%20tekst%20Predloga%20sporazuma.pdf>

<sup>16</sup><http://euobserver.com/media/src/0807580ad8281acfa2a89e38c49689f9.pdf>

qershor 2013, në takimin e trembëdhjetë me radhë të të dy Kryeministrave, u diskutuan dhe u ra dakord në çështjet lidhur me drejtësinë, policinë dhe zgjedhjet komunale.<sup>17</sup>

a) Përshtatja e Kornizës Ligjore:

Plani i Zbatimit kërkon që të ndërmerren të “gjitha ndryshimet e nevojshme ligjore” edhe nga Kosova edhe nga Serbia, të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së Parë deri në mesin e qershorit 2013. Ky afat përfundimtar nuk është respektuar.

Marrëveshja e Parë e arritur në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë më 19 prill 2013, krijon de-facto një qeveri serbe të Kosovës (Asociacioni/bashkësia), me garanci ligjore kundërthënëse në raport me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin në fuqi. Prandaj, qeveria ia kaloi marrëveshjen Kuvendit të Kosovës më 28 maj 2013, si Projektligj për ratifikimin e "Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare mbi Parimet e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" dhe planin e zbatimit të marrëveshjes.<sup>18</sup> Sipas Kushtetutës së Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare duhet të ratifikohet nga dy të tretat (2/3) e votave saherë që ndryshohen çështjet e territorit, paqes, aleancave, çështjeve politike e ushtarake dhe të drejtave e lirive themelore.<sup>19</sup> Krahas kësaj, marrëveshjet ndërkombëtare – të ratifikuara nga Kuvendi i Kosovës – kanë epërsi mbi Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, në pajtim me nenin 19, paragrafin 2 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>20</sup> Nga ana tjetër, se a mund të cilësohet kjo marrëveshje si marrëveshje ndërkombëtare ka qenë objekt debati brenda Kosovës, meqë marrëveshja është sigluar si draft autentik përfundimtar, por nuk është nënshkruar as nga kryeministri serb e as nga PL Ketrin Eshton.<sup>21</sup> Më 27 qershor 2013, Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen si marrëveshje ndërkombëtare me 84 vota pro, 3 kundër dhe 1 abstenim.

Marrëveshja e Parë u votua po ashtu si Rezolutë nga ana e Kuvendit të Kosovës, me dy të tretat e votës shumicë, më 22 prill 2013.<sup>22</sup> Qeveria e Serbisë në takimin qeveritar të datës 22 prill votoi miratimin e Marrëveshjes së Parë, të përcjellur me një votim tjetër miratimi nga Kuvendi i Serbisë më 26 prill 2013, me 173 vota pro, 24 kundër, dhe një abstenim, nga gjithsej 250 deputetë.

Ndërkohë, Kosova vazhdoi të amendamentojë ligjet e veta në mënyrë që të implementojë kërkesat për Marrëveshjen e Parë. Në qershor, tre propozime u dërguan në Kuvend për amendamentimin e Ligjit mbi Vetë-qeverisjen Lokale, Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, si dhe Projekt-ligjin për Amnesti.

Mbetet e paqartë se si do të ndryshohen shumë ligje. Fillimisht, një zyrtar i lartë i zyrës së Kryeministrit deklaroi se do të ndryshohen rreth 40 deri 50 ligje.<sup>23</sup> Sipas informatave të marra deri më 26 qershor nga Qeveria e Kosovës, vetëm tre ligje kanë nevojë për amendamentim p.sh ligjet që i janë dërguar Kuvendit. Kjo është një tendencë e re për të udhëhequr procesin e përshtatjeve ligjore qoftë pas ratifikimit të Marrëveshjes së Parë apo siç është më e mundur përmes interpretimit me kreativitet të

<sup>17</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/137550.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/137550.pdf)

<sup>18</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_132-te\\_te\\_Qeverise\\_2013.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_132-te_te_Qeverise_2013.pdf)

<sup>19</sup> Shih Nenin 18, paragrafet 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës tek <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>.

<sup>20</sup> Neni 19, paragrafi 2 deklaron se “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.”

<sup>21</sup> Shih Marrëveshjen e Parë tek

<http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2013/04/20/3224318/Originalni%20tekst%20Predloga%20sporazuma.pdf>

<sup>22</sup> <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,5582>

<sup>23</sup> <http://www.gazetatribuna.com/en/?FaqeID=2&LajmID=310>

tepruar të ligjeve aktuale. Në cilindo rast, edhe nëse vendimet nuk janë koherente me kornizën e tanishme ligjore të Kosovës, ratifikimi i marrëveshjes së parë si marrëveshje ndërkombëtare e tejkalon edhe Kushtetutën edhe ligjet e Kosovës, dhe kështu pamundëson iniciativat ligjore kundrejt zbatimit të dispozitave ligjore që rrjedhin nga Marrëveshja.

Në anën e Serbisë, mbetet e paqartë se kur Beogradi do të bëjë kodifikimin ligjor të Marrëveshjes së Parë. Shumë zyrtarë nga Beogradi kanë thënë se Serbia do të miratojë "Ligjin për autonomi substanciale për Kosovë e Metohi", duke përfshirë në një fazë të mëvonshme dispozitat për Bashkësinë e Komunave Serbe.

Kuvendi i Kosovës ratifikoi Marrëveshjen e Parë pa iu shpjeguar paraprakisht Kosovës për hapat ligjor që Serbia do t'i ndërmerret drejt implementimit të Marrëveshjes. Kjo gjë mund t'a çojë zbatimin e marrëveshjes në një pozitë pat, për shkak të "dykuptimisë së kreative" e cila i jep autoritetin të dyja palëve që Marrëveshjen ta shikojnë nëpërmjet perspektivave të veta ligjore, psh. Kosova si marrëveshje ndërkombëtare, Serbia si punë të brendshme, nëpërmjet dekretimit të ligjit kushtetues.

#### b) Bashkësia e Komunave Serbe:

Marrëveshja e parë mundësoi themelimin e Bashkësisë së Komunave Serbe (ZSO). Qeveria e Serbisë më 14 qershor 2013 emëroi Ekipin Menaxhues të ZSO-së. Qeveria e Serbisë ka emëruar katër zyrtarë të këtij ekipi: Igor Kalamar (NS) - Mitrovicë Veri, Llubomir Maric (SNS) - Zveçan, Dragan Jablanovic (SPS) - Leposaviç, dhe Dejan Radojkovic (SNS) - Zubin Potok.<sup>24</sup> Ky Ekipi Menaxhues do të përpilojë statutin e ZSO-së, me autoritet qeverisës të përkohshëm deri pas zgjedhjeve komunale. Pas zgjedhjeve komunale, Ekipi Përgatitor do të shpërbëhet. Prishtina dhe Beogradi akoma duhet të prodhojnë - përmes një grupi punues - planin e detajuar dhe afatin kohor për integrimin e personelit serb të sigurisë në strukturat e Kosovës dhe krijimin e strukturave çfarëdo strukture të re të kërkuar në bazë të marrëveshjes, që do të ekzekutohen me ndihmën e EULEX-it.

Ekipi Menaxhues i ZSO-së funksionon jashtë autoritetit të shtetit të Kosovës. Emërimi i tij nga ana e Beogradit ka krijuar precedent për epërsi të Serbisë dhe qeverisje të përbashkët me Prishtinën në të ardhmen lidhur me Kosovën veriore.

Më 18 qershor 2013 Qeveria e Kosovës ndryshoi Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, për të përfshirë në të ZSO-në, duke përfshirë edhe dispozitat për shpërbërjen e ZSO-së dhe fushëveprimin e përgjithshëm të punës së saj, dhe ndryshoi Ligjin mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Komuniteteve dhe Anëtarët e Tyre – i cili specifikon përfaqësimin e ZSO-së në Këshillin Konsultativ me Komunitete (KKK) në kuadër të Zyrës së Presidentit (ZP).

Plani i Zbatimit bëri thirrje për krijimin e një Ekipi Menaxhues nga të dy palët për themelimin e ZSO-së deri në fund të majit 2013. Ky afat nuk është respektuar. Krahas kësaj, nuk pati miratim formal nga ana e Qeverisë së Kosovës të Ekipit Menaxhues të emëruar nga Serbia, siç është paraparë me Planin e Zbatimit.

#### c) Policia:

Plani i Zbatimit bëri thirrje për themelimin e një grupi punues të përbashkët të Kosovës dhe Serbisë për zbatim të Neneve 7-9 të Marrëveshjes së Parë, si dhe për emërimin e Ushtruesit të Detyrës të

<sup>24</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/137476.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/137476.pdf)

Komandantit Rajonal të Policisë për katër komunat veriore serbe të Kosovës, deri në maj 2013. Ky afat nuk është respektuar.

Pas takimit të kryeministrave në Bruksel më 20 qershor, u emërua ushtruesi i detyrës së Drejtorit Rajonal të Policisë për katër komunat veriore nga ministri Kosovar Bajram Rexhepi më 25 qershor 2013, i propozuar nga Beogradi, në emër të ZSO-së dhe komunave veriore. Nuk kishte asnjë bazë ligjore për emërimin e Drejtorit Rajonal të Policisë së Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës së Veriut. Megjithatë, ligji për Policinë e Kosovës, në nenet 40, 41 dhe 42<sup>25</sup> jep detaje lidhur me emërimet e Drejtorëve Rajonalë të Policisë dhe të Komandantëve të Stacioneve në komunat me shumicë serbe, pas propozimit të Kuvendit Komunal dhe miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Krijimi i Komandave Rajonale dhe juridiksioni territorial i tyre lejohen vetëm pas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Asnjë propozim nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë nuk referohet si bazë për vendimin e Ministrit.<sup>26</sup>

Nenad Djuric, i emëruar nga Ministri i Kosovës Bajram Rexhepi si Drejtor Rajonal për Rajonin-Mitrovica e Veriut, u shkarkua në vitin 2011 nga shërbimi në Policinë e Kosovës, me propozimin eksplicit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe vendimin e ministrit Bajram Rexhepi. Djuric kishte qenë i afërt me Zvonko Veselinoviç dhe qarqe tjera kontroverze e të fshehta në veri të Kosovës, dhe u shkarkua nga Policia e Kosovës për sjellje të pahijshme dhe mosbindje si dhe ndihmesë në aktivitete kriminale. Emërimi i tij është bërë edhe para votimit të Ligjit për Amnisti nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Nga mesi i qershorit, Serbia shpалosi personelin prej 800 vetash e sponsoruar nga ajo për sigurinë e veriut të Kosovës, duke përfshirë edhe emra të punësuarish në gjyqësor, dhe në pajtim me Marrëveshjen e Parë ka kërkuar integrimin e plotë të tyre në institucionet e Kosovës.

d) Drejtësia:

Neni 10 i Marrëveshjes mbi Parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve<sup>27</sup> parasheh integrimin dhe funksionimin e autoriteteve gjyqësore brenda kornizës ligjore të Kosovës. Për më tepër, marrëveshja deklaroi se Gjykata e Apelit në Prishtinë do të formojë një panel të përbërë nga shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovës, që do të merren me të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë si nga stafi administrativ ashtu edhe gjyqtarë, do të ketë selinë përgjithmonë në veri të Mitrovicës (Gjykata e Qarkut të Mitrovicës). Çdo panel i divizionit të lartpërmendur do të jetë i përbërë nga shumicë gjyqtarësh Serbë të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të gjykojnë varësisht prej natyrës dhe rastit të caktuar.<sup>28</sup> Përveç kësaj, Plani i Zbatimit të marrëveshjes në klauzolën e saj të katërt thekson se deri më 15 qershor, Serbia do të ofrojë informacion mbi numrin e personelit të saj gjyqësor të punësuar në Kosovë, të cilët kanë shprehur interes për t'u bashkuar strukturave ekuivalente të Kosovës, menjëherë pasi të jetë miratuar ligji për Amnisti, ndërsa që integrimi i autoriteteve gjyqësore duhet të ketë përfunduar deri në fund të vitit. Të gjitha objektet gjyqësore serbe në Kosovë do të mbyllen dhe do të ngriten organet e reja, e do të integrohet personeli i ri në sistemin e Kosovës.<sup>29</sup>

<sup>25</sup> Shih Ligjin mbi Policinë në [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Ligji\\_i\\_Policise1.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Ligji_i_Policise1.pdf)

<sup>26</sup> Po aty, Neni 32.

<sup>27</sup> [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/EN/foraff/136875.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/136875.pdf)

<sup>28</sup> <http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2013/04/20/3224318/Originalni%20tekst%20Predloga%20sporazuma.pdf>

<sup>29</sup> <http://euobserver.com/media/src/0807580ad8281acfa2a89e38c49689f9.pdf>

Nga mesi i qershorit, Serbia informoi degën e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë veriore që të pranonte raste deri më 15 qershor, të zgjidhë sa më shumë çështje gjer më 31 gusht 2013, dhe të ndërpresë kontratat më 1 shtator 2013.

e) Ligji mbi Amnisti:

Plani i zbatimit bën thirrje për dekretimin e Ligjit për Amnisti të Kosovës deri në mesin e qershorit 2013. Ky afat nuk është respektuar. Më 25 qershor 2013 pas marrëveshjes së arritur me palën serbe në Bruksel, Qeveria e Kosovës miratoi projekt-ligjin për Amnisti.<sup>30</sup> Serbia kushtëzoi shpërbërjen e strukturave të financuara policore dhe gjyqësore përmes miratimit të këtij ligji.<sup>31</sup>

f) Zgjedhjet Komunale:

Plani i zbatimit ka paraparë fundin e tetorit 2013 si muajin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Kosovë. Ky afat nuk është respektuar. Zgjedhjet komunale u diskutuan në takimin e dy kryeministrave më 20 qershor 2013. Asnjë detaj nuk është bërë publik lidhur me datën e caktuar për zgjedhje. Vetëm Kryeministri i Serbisë Daçic deklaroi se zgjedhjet do të mbahen më 3 nëntor 2013. Më vonë, Thaçi po ashtu njoftoi se Kosova do të mbajë zgjedhjet e saj komunale më 3 nëntor 2013. Kjo u konfirmua edhe disa ditë më herët, nga ana e zëvendës Kryeministres Edita Tahiri, se data e caktuar për zgjedhje komunale ishte propozuar nga BE-ja si data më adekuate.<sup>32</sup> Të gjitha partitë politike të Kosovës, përveç Lëvizjes Vetëvendosje, kanë përkrahur datën 3 nëntor si datën për mbajtje të zgjedhjeve komunale, përkundër një koncensusi të mëhershëm nga të gjitha partitë që zgjedhjet komunale të mbahen deri më 20 tetor 2013.

#### **IV. Rruga Përpara**

Normalizimi i plotë i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është shumë me rëndësi për të ardhmen e stabilitetit dhe zhvillimin demokratik të Ballkanit Perëndimor. Pozita aktuale e shumicës së shteteve të BE-së është se Serbia nuk mund të hyjë në BE pa njohjen e pavarësisë së Kosovës, pa marrë parasysh se nuk ka thirrje publike për atë vendim. Përafrimi me BE-në edhe i Kosovës e edhe i Serbisë duhet të vazhdojë nga tranzicioni aktual drejt normalizimit dhe nga normalizimi drejt bashkëpunimit të plotë ndër-shtetëror në nivele bilaterale dhe multilaterale. Ky proces do të zgjasë, por për një normalizim dhe bashkëpunim të suksesshëm, duhet të shtyhen përpara *çështjet kyçe* të mëposhtme:

Çështjet kryesore afat-mesme:

- “Marrëveshja Gjithëpërfshirëse” mbi normalizimin e marrëdhënieve – Në mungesë të njohjes zyrtare reciproke, një marrëveshje detyruese juridike e normalizimit të marrëdhënieve duhet të rregullojë tërë marrëdhënien mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje gjithashtu duhet që çështjen e njohjes së Kosovës ta sjell nga sfera ndërkombëtare në nivel çështjeje dypalëshe të pazgjidhur me Serbinë. Ajo, ndër të tjera, duhet të hapë derën për anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe të gjitha organizatat tjera ndërkombëtare shumëpalëshe. Kjo marrëveshje duhet po ashtu të përfshijë aspektet e bashkëpunimit në nivele bilaterale dhe multilaterale; bashkëpunim në çështje të sigurisë dhe në luftimin e krimit të organizuar kufitar; themelimin të bazës për bashkëpunim të tutjeshëm në fushën e mbrojtjes e cila do të mundësonte

<sup>30</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_135-te\\_te\\_Qeverise\\_2013.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_135-te_te_Qeverise_2013.pdf)

<sup>31</sup> <http://www.telegrafi.com/lajme/vulin-shperberja-e-strukturave-ilegale-pas-ligjit-per-amnisti-2-32932.html>

<sup>32</sup> <http://www.telegrafi.com/lajme/propozimi-i-be-se-zgjedhjet-lokale-me-3-nentor-2-33410.html>

tërheqjen e KFOR-it në vitet e ardhshme; si dhe në institucionalizim të bashkëpunimit ekonomik.

- **Pajtimi** – Çështja e 1,754 personave të zhdukur është pengesë e madhe në procesin e pajtimit, i cila mbështet normalizimin dhe bashkëpunimin afatgjatë. Kjo çështje humanitare duhet të merr focus vendimtar, me përcjellje ligjore deri në hetim dhe persekutim të kryesve të krimeve mbi civilët. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur brenda vendit (IDP) të cilët duan të kthehen – shqiptarët në Kosovën veriore dhe serbët në anën jugore të Ibrit. Dialogu ndër-etnik dhe ndër-fetar në Kosovë duhet të fillojë depolitizimin e institucioneve fetare dhe të rrisë në nivel themelor mirëkuptimin e ndërsjelltë dhe tolerancën.
- **Aspektet kryesore të zbatimit të Marrëveshjes së Parë** - Implementimi i Marrëveshjes së Parë do të jetë shumë kompleks dhe i vështirë. Është i nevojshëm rregullimi i plotë i çështjeve të arsimit dhe shërbimit civil për serbët e Kosovës si dhe kujdesit shëndetësor të Beogradit në Kosovë (stafi administrativ i institucioneve paralele). Janë rreth 21,000 nga gjithsej rreth 50,000 njerëz të cilët banojnë në Kosovë, por që paguhen nga Beogradi e që punojnë në strukturat e Serbisë në Kosovë. Mes tjerash, e ardhmja e punësimit të tyre, kontratat dhe sigurimet, duhet të sqarohen sa më shpejt që të jetë e mundur.
- **Pronësia politike** – udhëheqësitë e Prishtinës dhe Beogradit duhet të pushojnë së portretizuar dialogun kinse është presion nga Brukseli dhe Uashingtoni, dhe në vend të kësaj, ata duhet të zhvillojnë retorikë politike e cila shërben drejt normalizimit afatgjatë dhe bashkëpunimit eventual të të dy shteteve.

#### Çështjet kryesore afatshkurte

- **Legjitimiteti i institucioneve** – komunat e reja dhe institucionet që do të themelohen pas zgjedhjeve komunale në nëntor 2013, duke përfshirë ato në veri, duhet të jenë rezultat i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Këto institucione duhet të kenë besimin, mirëbesimin dhe legjitimitetin e popullatës locale. Edhe shqiptarët e Kosovës ashtu edhe serbët e Kosovës duhet të kenë besim në procesin demokratik. Në të njëjtën kohë, numri i votuesve në komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe duhet të jetë i konsiderueshëm në mënyrë që të ketë legjitimitet; në të kundërtën, pjesëmarrja e ulët do të rrezikojë të tërë përfshirjen e veriut brenda kornizës së re ligjore dhe insitucionale të Kosovës.
- **Veprimi ligjor nga Serbia** – “Ligji Kushtetues” apo ”Ligji mbi Autonominë e Kosovës e Metohisë” i Beogradit i cili në mënyrë eksplicite do të përfshijë ZSO-në, do të shpiejë në legjitimitet ligjor kundërthënës dhe të dyshimtë të ZSO-së. ZSO nuk mund të jetë edhe pjesë e kornizës ligjore të Kosovës edhe të Serbisë në të njëjtën kohë.
- **Zgjidhja e energjisë dhe telekomunikacionit** – Zgjidhja përfundimtare për energjinë dhe telekomunikacionin është thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të potencialit të Kosovës në energji dhe telekomunikacion. Negociatat e vazhdueshme në mes të të Kosovës dhe Serbisë për çështjen e Telekomunikacionit, përmes së cilës Kosova do të dojë të miratojë “kodin shtetëror” nga ITU, ndërsa Serbia dëshiron të legalizojë operacionet e operatorit të saj Telekom Srbije dhe

rrjetit mbi territorin e Kosovës, apo së paku, në pjesët ku jeton shumica e popullsisë serbe. Ndërsa që marrja e "kodat shtetëror" është e rëndësishme dhe në interes të Kosovës, Kosova duhet të jetë e kujdesshme për opcionet që ndodhen në tryezë. Operacionet e telekomunikacionit në Kosovë janë të hapura për të gjithë qytetarët e saj dhe nuk ka kurrfarë ndarje etnike meqë shërbimet ofrohen për të gjithë qytetarët e Kosovës. Çmimet janë konkurruese, madje edhe në krahasim me vendet e rajonit. Serbët e Kosovës kanë qasje të barabartë në shërbimet e telekomunikacionit dhe ofruesit kryesorë të telekomunikacionit kanë degë në zonat e banuara me shumicë serbe dhe rrjetet e tyre mbulojnë pothuajse tërë territorin. Prandaj, nuk ka arsye që Telekom Srbije të legalizojë shërbimet e saj në Kosovë përmes një dialogu politik. Megjithatë, Telekom Srbije duhet të inkurajohet që të aplikojë për licencë të telekomit atëherë kur Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) dhe Qeveria e Kosovës të vendosin për një gjë të tillë, proces ky i cili duhet të jetë i hapur dhe i barabartë për të gjithë ata që janë të interesuar në marrjen e licencës.



## ANEKS - ZBATIMI I MARRËVESHJEVE TEKNIKE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

### 1. Librat Amzë

Marrëveshja: Kjo marrëveshje është arritur më 2 korrik 2011, në raundin e pestë të dialogut teknik për krijimin e një 'regjistri civil plotësisht të besueshëm në Kosovë'<sup>33</sup>, që kërkon nga Serbia dorëzimin e kopjeve të origjinaleve të EULEX-i, dhe nga EULEX-i të Qeveria e Kosovës. EULEX-i kryeson 'komisionin e përbashkët' trepalësh të përbërë edhe nga ekspertët e regjistrimit civil nga Serbia dhe Kosova, që kanë për detyrë të vërtetojnë origjinalitetin e kopjeve të dorëzuara nga Serbia. Serbia është pajtuar që të dorëzojë vetëm kopjet e Librave amzë në vend se t'i kthejë librat origjinalë në Kosovë. Qeveria e Kosovës supozon se zbatimi i plotë i kësaj marrëveshjeje do të çojë deri te mbyllja e të gjitha strukturave paralele serbe në këtë zonë, që do të thotë mbyllja e zyrave ilegale të drejtuara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) që është përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve të tilla.

Zbatimi: Marrëveshja ka pasur një fillim të ngadaltë. Zbatimi varej nga vullneti i Serbisë që të nis me skanimin e dokumenteve. BE-ja ka ofruar financimin e një projekti për blerjen e pajisjeve dhe trajnimin e personelit në Serbi për këtë qëllim. Sipas raportimit të autoriteteve të Kosovës "edhe pas premtimit të Serbisë për të përshpejtuar zbatimin, duke filluar nga 20 marsi i 2012-ës me kapacitetin prej 10 stacioneve punuese / 10 personave", procesi filloi me dy muaj vonesë (më 10 maj 2012) dhe me gjysmë kapaciteti (pesë stacione punuese/pesë persona).<sup>34</sup>

Vonesat janë shkaktuar edhe nga ana e Kosovës. Me të vërejtur se disa dokumente të transferuara nuk ishin të plota, ekipi i ekspertëve të Kosovës dërgoi një raport mbi mangësitë të grupi trepalësh zbatues. Raporti është dorëzuar dy muaj më vonë në vend se të dorëzohej vetëm një javë më pas, ashtu siç ishte premtuar fillimisht. Gjithashtu, vonesat janë shfaqur në plotësimin e listave për shkak të mungesës së marrëveshjes për formatin e listave dhe vonesave në të dyja anët (të tilla si sigurimin e listave, por edhe vonesa në paraqitjen e reagimeve dhe verifikimin e listave me të dhënat e Kosovës).<sup>35</sup> Përveç kësaj, disa lista të inventarit të ofruara fillimisht nga Qeveria e Serbisë kanë përfshirë 'dublikatat', me fjalë të tjera librat amzë, të cilat ishin në origjinal në Kosovë (p.sh. në Gjakovë, në Deçan) dhe kishin një dublikatë në Serbi.

Tutje, kah mesi i 2012-ës, zbatimi i *Projektit të Skanimit në Shkallë të Gjerë* ende nuk kishte filluar. Qeveria e Kosovës ka raportuar se Serbia ka kërkuar nga BE-ja një shumë prej 2.5 milionë eurosh për zbatimin e projektit. Megjithatë, kjo deklaratë nuk ishte vërtetuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), që ishte zgjedhur si partner zbatues për projektin nga ana e BE-së.<sup>36</sup> Pos kësaj, me qëllim të racionalizimit të kostos, Kosova ia ka dhënë Serbisë softuerin e vet të skanimit, që ka rezultuar me uljen e kostos për 400

<sup>33</sup> Shih Konkluzat e Dakorduara 2 korrik 2011 për Librat e Regjistrimit Civil, paragrafi 1.

<sup>34</sup> Raporti për zbatimin e marrëveshjeve të DT, shkurt-gusht 2012, Raportimi nga autoritetet e Kosovës, 23.08.2012.

<sup>35</sup> Komunikimi përmes postës elektronike me Këshillin Danez për Refugjatë, 30 janar 2013.

<sup>36</sup> Shifra e parë e paraqitur nga Zyra për çështje eksperte dhe operacionale në procesin e negociatave të Qeverisë së Serbisë në lidhje me koston e kërkuar arriti në përafërsisht 1.2 milionë euro. BE-ja e financon projektin me 1 milion euro, derisa Qeveria e Kosovës ofroi softuerin e zhvilluar më parë për një projekt të ngjashëm të kryer në Kosovë dhe të propozuar nga Qeveria e Kosovës për metodën e regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave. Qeveria serbe e bashkëfinancon projektin me mbulimin e pagave të 50 punonjësve që punojnë në përpunimin e të dhënave (1 ekspert i TI-së dhe 49 ndihmës për përpunimin e të dhënave). Përveç kësaj, të dyja delegacionet kanë caktuar koordinatorët (2 përkatës) dhe zyrtarët për verifikimin e të dhënave (5 nga Kosova dhe 4 nga Serbia), që mbështesin zbatimin e projektit. Komunikim përmes postës elektronike me DRC-në, 30 janar 2013.



mijë euro. Zbatimi filloi me vonesa të vogla në tetor të vitit 2012, pas përmbylljes së fazës përgatitore tre mujore në tetor me trajnimin e stafit.<sup>37</sup>

Sipas autoriteteve në Prishtinë, Kosova ka qenë mjaft efektive në përmbushjen e obligimeve të saja zbatuese. DRC-ja si partner zbatues i BE-së gjithashtu ka gjetur vullnet të përgjithshëm tek autoritetet e Kosovës për zbatimin e marrëveshjes.<sup>38</sup> Tutje, në tetor të 2012-ës, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës (MPB) ka lëshuar një akt nënligjor për zbatimin e marrëveshjes. Në mënyrë të veçantë, Udhëzimi Administrativ (UA) për përdorimin e kopjeve të certifikuara të regjistrave origjinal të gjendjes civile të Kosovës është lëshuar duke përcaktuar procedurat se si kopjet e vërtetuara në raste të veçanta duhet të konsiderohen si origjinale bazuar në marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel.<sup>39</sup> Ndonëse ligjshmëria e një UA të tillë është kontestuese (shih pjesën mbi zbatimin e marrëveshjeve me akte nënligjore) ajo ka shfaqur gatishmërinë nga ana e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të arritura me anë të akteve nënligjore.

Problemet: Raporti i tetorit të 2012-ës mbi gjendjen e zbatimit, i hartuar nga Brukseli, ka bërë të ditur vonesat nga ana serbe. Në të thuhet se "deri më sot Beogradi nuk i ka miratuar ndryshimet e nevojshme në ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për t'ia mundësuar EULEX-it rregullimin e kopjeve të regjistrave origjinal civil, të mbajtura për tu bërë", duke shtuar se "deri në këtë datë, Serbia nuk ka ofruar vërejtjet mbi opsionin e saj të preferuar për zbatimin, prej tri opsioneve të zhvilluara nga Komisioni i Përbashkët".<sup>40</sup>

Përkundër këtyre pengesave, në terren është vërejtur një përparim i ngadalshëm. Sipas EULEX-it në janar të 2013-ës, 972 kopje të vërtetuara të Librave amzë i janë dorëzuar Agjencisë për Regjistrim Civil të Kosovës. Në total deri në korriktë 2013-ës, EULEX-i ka dorëzuar mbi 4770 kopje të vërtetuara të Librave amzë, që mbulojnë komunat e Prishtinës (1013), Lipjanit (848), Obiliqit (264), Fushë Kosovës (219), Glllogocit (425), Podujevës (1066) dhe Gjilanit (935).<sup>41</sup> Kjo është vetëm rreth 30 përqindëshi i totalit të asaj që duhet t'i dorëzohet Kosovës, meqë është vlerësuar se Serbia mban përafërsisht 12.036 libra amzë nga Kosova.

## 2. Liria e Lëvizjes

Marrëveshja: Marrëveshja është arritur më 2 korrik 2011 dhe ka nisur të zbatohet më 26 dhjetor 2011. Qëllimi i marrëveshjes është mundësimi i udhëtimit të lirë brenda dhe përgjatë territorit të Kosovës dhe Serbisë. Pikat kryesore të kësaj marrëveshjeje janë: përdorimi i ndërsjellë i sistemit të letërnjoftimeve dhe të patentë shoferëve për udhëtimin ndërkuftar / kalimin e vijës kufitare, duke lejuar blerjen e sigurimit kufitar deri në arritjen e një marrëveshjeje komerciale për sigurimin e ndërsjellë të automjeteve, të lehtësuara nën udhëheqjen e BE-së; autoritetet e Beogradit do të lejojnë automjetet me targa KS të udhëtojnë lirshëm brenda territorit të Serbisë me targa të lejuara të përkohshme të automjeteve, duke përfshirë edhe përfundimin e paralelizmit të targarit të automjeteve në Kosovë, ku të gjithë pronarët e veturave në Kosovë do të përdorin targarat e automjeteve RKS ose KS. Kjo e fundit do të fus në

<sup>37</sup> Ibid.

<sup>38</sup> Ibid.

<sup>39</sup> Neni 2 i UA të MPB-së Nr. 37/2012 në [http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Udhezim\\_Administrativ\\_Nr\\_37\\_2012\\_anglisht.pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Udhezim_Administrativ_Nr_37_2012_anglisht.pdf)

<sup>40</sup> Zbatimi, Gjendja e tanishme, raportimi nga BE-ja, 3 tetor 2012.

<sup>41</sup> EULEX, Komunikatë për shtyp, Dorëzohen kopjet e librave amzë të Gjilanit, 1 korrik 2013

përdorim targat e automjeteve të Kosovës dhe letërnjoftimet në veriun e Kosovës deri në nëntor të vitit 2011.

Zbatimi: Në përgjithësi, zbatimi i marrëveshjes është duke shkuar mirë. Përmes kësaj marrëveshjeje është vendosur lëvizja e lirë e njerëzve nga Kosovë në Serbi dhe qytetarët e Kosovës tani mund të hyjnë në Serbi duke përdorur letërnjoftimet dhe pasaportat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, me përjashtim të veriut të Kosovës.

Sipas dokumenteve të MPB-së së Kosovës prej dhjetorit të 2011-ës deri në janar të 2013-ës në total 292 mijë e 889 persona kanë udhëtuar nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas – 148 mijë e 284 persona kanë hyrë në Kosovë nga Serbia.<sup>42</sup> Ka pasur 122 mijë e 742 vetura, 7 mijë e 706 autobusë dhe 39 mijë e 649 kamionë që kanë hyrë në Kosovë nga Serbia. Gjithashtu ka pasur 20 mijë e 628 vetura, 2 mijë e 438 autobusë dhe 5 mijë e 565 kamionë që kanë hyrë në Serbi nga Kosova me targat e automjeteve RKS; derisa ka pasur 15 mijë e 230 vetura, 2 mijë e 514 autobusë dhe 8 mijë e 205 kamionë me targat e automjeteve KS.

Po ashtu, vetëm kah fundi i prillit të 2013-ës, janë funksionalizuar dy pikëkalimet kufitare në Mutivodë dhe Muçibabë që lidhin Kosovën me Luginën e Preshevës. Udhëtarët e parë prej Kosovës me letërnjoftimet e Kosovës kanë nisur së udhëtuar më 1 maj të vitit 2013.<sup>43</sup> Ndërprerja e mëhershme e këtyre dy pikëkalimeve kufitare ka qenë gjithashtu problematike për shqiptarët etnik që duhej të udhëtonin nga Merdarja në Prishtinë – duke shtuar kohën e udhëtimit për pothuaj një orë. Shqiptarët etnik nga Presheva për udhëtim në Gjilan, duke e pasur të pamundur që të shfrytëzojnë pikëkalimet e mëparshme kufitare, janë detyruar që të përdorin pikëkalimin te Dheu i Bardhë dhe të udhëtojnë përmes Bujanocit, duke e bërë një vozhje më të gjatë për 25 minuta (rreth 1 orë).

Problemet: Zgjidhja e përkohshme për lëshimin e sigurimeve të veturave në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet një sfidë. Pagesat për sigurimin e automjeteve mbetet shumë të larta meqë Kosova ende nuk është anëtare e Byrosë së Kartonit të Gjellbër. Kosova dhe Serbia në mënyrë reciproke kanë aplikuar çmime të ndryshme të sigurimit për automjetet në kufij.

Automjetet e Serbisë paguajnë deri në 40 euro për hyrje në Kosovë që vlen deri në 40 ditë, 368 euro për 6 muaj dhe 603 euro për një vit të sigurimit të veturës. Ndryshe, veturat nga Kosova me targat KS dhe RKS duhet të paguajnë 100 euro për periudhën 30 ditore, përfshirë dhe 40 euro për targat e përkohshme të veturave të Kosovës me targat RKS duke përfshirë edhe tarifën ditore prej 1 euro dhe taksën kufitare prej 13 eurosh. Tarifat e tilla të larta bëjnë që udhëtimet ndërmjet dy vendeve të jenë shumë të shtrenjta, veçanërisht për qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në Serbi.

Kompanitë kosovare të sigurimit pas një presioni të publikut dhe të Qeverisë së Kosovës patën ulur tarifatat fillestare të sigurimit të automjeteve, kryesisht për shkak të ankesave të shqiptarëve etnik nga Lugina e Preshevës.

Targat e automjeteve KS dhe letërnjoftimet ende nuk janë futur në përdorim në veriun e Kosovës për serbët etnik. Ata përdorin targat e Serbisë dhe nuk paguajnë tarifatat e sigurimit të automjeteve. Kjo

---

<sup>42</sup> Komunikimi i KIPRED-it me postë elektronike me zyrtarin e MPB-së, 28 janar 2013.

<sup>43</sup> 'Nisi sot zbatimi i IBM-së në Mutivodë dhe Muçibabë' në <http://kosovapress.com/?cid=1,2,164441&app=cms>

situatë paraqet një shkelje të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, e cila në mënyrë të qartë thekson se marrëveshja për targa e automjeteve do të zbatohet nga 11 nëntori i 2011-ës.

### 3. Vulat Doganore

Marrëveshja: Marrëveshja që arritur me 2 shtator të vitit 2011. Konkluzionet theksonin se palët janë pajtuar që të 'sigurojnë qarkullimin e lirë të mallrave në pajtueshmëri me CEFTA-n'.<sup>44</sup> Vulat doganore të Kosovës janë emërtuar si 'Doganat e Kosovës' që prej administrimit të UNMIK-ut dhe nuk kanë ndryshuar pas shpalljes së pavarësisë, gjë që u pranua nga Serbia. Kjo nënkuptonte se Qeveria e Kosovës pat hequr dorë nga e drejta për t'iu referuar emrit të saj kushtetues "Republika e Kosovës" në dokumentet sanitare dhe veterinare të nevojshme për eksport. Ky përdorim i vulave do të pasqyrohet në të gjitha dokumentet dhe komunikimet tjera që shoqëronin lëvizjen e mallrave.

Marrëveshja mbi Vulat Doganore nënkuptonte gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme të pranueshme për të dyja palët dhe mundësimin e futjes së mallrave nga Kosova në Serbi. Zbatimi ka nisur në shtator të 2011-ës, fillimisht nga ana e Kosovës. Serbia pat nisur zbatimin e pranimit të vulave të Kosovës pa e informuar BE-në dhe CEFTA-n<sup>45</sup> në lidhje me fillimin e zbatimit.

Zbatimi: Sipas Qeverisë së Kosovës "marrëveshja është duke u zbatuar në një nivel të kënaqshëm".<sup>46</sup> Autoritetet në Prishtinë ankohen në lidhje me pritjet e gjata (deri në 12 orë) të eksportuesve kosovarë në kufirin me Serbinë. Në anën tjetër nuk ka pas raportime për vonesa në anën e Kosovës. BE-ja ka raportuar se "pas vështirësive fillestare tani duket se kamionët nga Kosova me dokumente të rregullta janë duke hyrë lirshëm në Serbi."<sup>47</sup>

Problemet: Megjithatë, pala kosovare vazhdon të ankohet se: a) Serbia vazhdon që të kërkojë grumbullimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për eksportet nga Kosova. Kjo detyron eksportuesit kosovarë që të regjistrohen në zyrat e Republikës së Serbisë që veprojnë ilegalisht brenda territorit të Kosovës; b) Është raportuar se Serbia ka ndaluar hyrjen e mallrave me certifikatat e lëshuara nga Agjencia kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë, madje edhe për transit nëpër territorin e Serbisë për vendet e treta dhe vendet e BE-së dhe anasjelltas.<sup>48</sup> Sipas zyrtarëve të kësaj Agjencie, eksportuesit kosovarë nuk kanë raportuar për probleme të kësaj natyre, përpos në një rast të vetëm. Në përgjithësi, eksportuesit kanë vazhduar që të hyjnë lirshëm në Serbi me vërtetimet nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Tutje, Agjencia ka bërë të ditur se Serbia kërkon një vërtetim tjetër të kontrollit të fitosanitarisë, që nga zyrtarët e Kosovës konsiderohet si e panevojshme.<sup>49</sup>

---

<sup>44</sup> Shih Konkluzat e Dakorduara 2 shtator 2011, për 'Vulat Doganore'.

<sup>45</sup> Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (The Central European Free Trade Agreement) - CEFTA është një marrëveshje e tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së. Marrëveshja origjinale CEFTA ishte nënshkruar nga Grupi i shteteve të Vishegradit. Nga 1 maji 2007, palët e marrëveshjes CEFTA janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (UNMIK).

<sup>46</sup> Azhurimi i Kosovës mbi zbatimin e marrëveshjeve të DT 23.08.12, shkurt – gusht 2012.

<sup>47</sup> Zbatimi, gjendja e tanishme, raportimi i BE-së për zbatimin e marrëveshjeve të DT, 3 tetor 2012.

<sup>48</sup> Gjendja e tanishme në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut Teknik, shtator 2012 – nëntor 2012, Raportimi nga autoritetet e Kosovës, 16 nëntor 2012.

<sup>49</sup> Komunikimi me telefon i KIPRED-it me zyrtarin e Agjencisë Kosovare të Ushqimit dhe Veterinarisë, 12 qershor 2013.

#### 4. Shënimet Kadastrale

Marrëveshja: Kjo marrëveshje është arritur më 2 shtator 2011 dhe ngjashëm me çështjen e Librave amzë, synon që të ofroj një zgjidhje për Shënimet Kadastrale të Kosovës, të marra nga Serbia në qershor të vitit 1999. Konkluzioni ka marrë parasysh të drejtën legjitime të njerëzve për kërkesat pronësore prandaj dhe palët u pajtuan që të krijojnë një kadastrë plotësisht të besueshëm në Kosovë. Nën monitorimin e BE-së u krijua grupi trepalësh i zbatimit. Përbëhej nga ekspertët nga Kosova, Serbia dhe BE-ja, të cilët përmes një agjencie teknike do të veprojnë si një mekanizëm vendimmarrës. Agjencia duhet të identifikoj të gjitha zbrazësitë në shënimet kadastrale të para 1999-ës dhe përfundimisht të përcaktoj saktësinë e shënimeve kadastrale. Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës është emëruar si shkallë e dytë e apelit ndaj vendimeve të agjencisë teknike.

Zbatimi: Në vitin 2012 është raportuar se ka pasur përparim të kufizuar në zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga secila palë. Pala kosovare ka vonuar nxjerrjen e ligjeve të kërkuara për themelimin e Agjencisë teknike për zbatimin e Marrëveshjes. Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) është miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në nëntor të vitit 2012 dhe mbetet të miratohet edhe nga ana e Kuvendit të Kosovës.<sup>50</sup> BE-ja në anën tjetër deri tani ka prezantuar idetë fillestare për mënyrën e zbatimit të konkluzioneve operationale.<sup>51</sup>

Problemet: Ndërkohë, pala serbe ende nuk ka filluar me skanimin e dokumenteve kadastrale që në total janë 12 milionë faqe. Deri më sot, hapi i vetëm i ndërmarrë nga Serbia është dorëzimi i listës së dokumenteve kadastrale që janë marrë nga Kosova te Grupi i Zbatimit në mbledhjen e 15 prillit të vitit 2012.

#### 5. Pranimi i Diplomave Universitare

Marrëveshja: Marrëveshja në parim për pranimin reciprok të diplomave është arritur më 2 korrik 2011 dhe është finalizuar më 21 nëntor 2011. Marrëveshja përcakton pranimin e diplomave universitare nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA). Asociacioni do të vërtetoj diplomat e lëshuara nga të dyja palët duke emëruar Komisionin e ekspertëve të Akademikëve Evropianë. Efekti përfundimtar i marrëveshjes duhet të jetë që secila palë të pranoj kualifikimet e deklaruara në diploma.

Zbatimi: Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nisi më 1 mars 2012 nga autoritetet e Kosovës, me hapjen e një zyre të zbatimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe në bashkëpunim me SPARK-un, derisa Asociacioni i Universiteteve Evropiane (AEU) ka nisur të vërtetoj diplomat e Kosovës. Më 26 korrik 2012 ishin vërtetuar 73 diploma, derisa në janar të 2013-ës janë vërtetuar edhe një grumbull tjetër prej 100 diplomash, pra gjithsej 173 diploma të vërtetuara. Deri më sot, numri i përgjithshëm i diplomave të vërtetuara është 186 sosh. Zyra e Kryesuesit të dialogut teknik të Qeverisë së Kosovës monitoron zbatimin e kësaj marrëveshjeje në bashkëpunim me autoritetin komunal të shqiptarëve etnikë nga Lugina e Preshevës.

Në parim, grupi i përbërë nga 5-7 anëtarë, takohet çdo tre muaj dhe vendos mbi vërtetimin e diplomave, që është një proces i shtytur nga kërkesat e studentëve.

<sup>50</sup> Gjendja e tanishme në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut Teknik, shtator 2012 – nëntor 2012, Raportimi nga autoritetet e Kosovës, 16 nëntor 2012

<sup>51</sup> Zbatimi, gjendja e tanishme, raportimi i BE-së për zbatimin e marrëveshjeve të DT, 3 tetor 2012.

Problemet: Nuk është e sigurt nëse diplomat e vërtetuara do të pranohen në Serbi, pasi universitetet dhe punëdhënësit serbë nuk janë të obliguar që ti pranojnë ato si të vlefshme. Në rastet kur pala serbe i pranon diplomat, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës në disa raste ka ndodhur që emërtimi “Kosova dhe Metohija” është shtuar në diploma.<sup>52</sup>

#### 6. Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi rajonal

Marrëveshja: Kjo marrëveshje është arritur më 24 shkurt 2012, pasi që çështja ishte diskutuar në disa raunde të bisedimeve. Si përfundim, u arrit pajtimi që Kosova do të përfaqësohej në organizimet *rajonale* me një fusnotë dhe një yll pranë emrit të Kosovës. Fusnota e cila do të përdorej me yllin do të lexonte: ‘Ky emërtim është pa paragjykim mbi pikëpamjet lidhur me statusin dhe është në harmoni me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe mendimin e GJND-së mbi Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës’. Marrëveshja nuk specifikon qartë përdorimin e fusnotës dhe ka lejuar interpretime të ndryshme nga Kosova dhe Serbia, por edhe interpretime të ndryshme nga organizatorë të takimeve në forume dhe organizata rajonale. Për më tepër, konkluzat gjithashtu parashikojnë që BE-ja, si lehtësuese, duhet gjithashtu t’i informojë organizatat relevante rajonale për emërtimin e dakorduar mbi përfaqësimin dhe nënshkrimin, duke monitoruar gjithashtu implementimin e konkluzave.

Zbatimi: Deri në mes të 2012-ës, Serbia po e kushtëzonte pjesëmarrjen e Kosovës në organizime të ndryshme rajonale me shtypjen e fusnotës në një vend specifik në dokumentet relevante.

Prej datës 31 maj 2013, Kosova ka aplikuar për anëtarësim në 34 organizata rajonale, ku 13 prej tyre janë përgjigjur pozitivisht dhe 2 negativisht. Nga 34 aplikime nga Kosova, deri në pranverë të vitit 2013, pesë nga to kanë marrë një përgjigje pozitive paraprake. Por deri më tani përgjigjet pozitive janë në pritje, ku një nga organizatat rajonale kushtëzon pranimin e tyre me pranimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata të tjera dhe dy të tjera janë nën mandatin e UNMIK-ut, me fjalë të tjera vetëm UNMIK-u mund të negociojë anëtarësimin e Kosovës në to.<sup>53</sup>

Jashtë listës së Cooper-it, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës ka aplikuar edhe në tetë organizata të tjera. Ata kanë marrë përgjigje pozitive nga pesë prej tyre, përgjigje negative nga njëra prej tyre dhe me dy nga to Ministria është në procesin e konsultimeve.<sup>54</sup>

Nga fillimi i 2013-ës, Ministria e Punëve të Jashtme është përqendruar që Kosova të jetë anëtare e SEECIP-së (Procesi për Bashkëpunim të Evropës Jug-Lindore). Takimi i programuar për Ministrat e Punëve të Jashtme të SEECIP-së u mbajt më 31 maj 2013 në Ohër të IRF të Maqedonisë nën kryesimin e Maqedonisë, derisa takimi Presidential ishte programuar të mbahej me 1 qershor 2013. Meqë Presidentja e Kosovës nuk ishte ftuar, organizatori ishte i detyruar ta anulojë takimin, për arsye se presidentët kroat, shqiptar dhe bullgar refuzuan të merrnin pjesë duke cituar si arsye lënien anash të Presidentes së Kosovës.<sup>55</sup>

Që nga dita që u arrit kjo marrëveshje janë mbajtur njëqind e tri (133) takime dhe ngjarje rajonale. Edhe Kosova edhe Serbia kanë marrë pjesë në gjashtëdhjetë e pesë (65) takime të tilla. Në njëzet e një (21)

<sup>52</sup> Intervistë me Koordinatorin e QeK për Diploma dhe Liri të Lëvizjes, 16 maj 2013.

<sup>53</sup> Intervistë me Koordinatorin e QeK për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, 8 maj 2013.

<sup>54</sup> Intervistë me Koordinatorin e QeK për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, 8 maj 2013.

<sup>55</sup> Komunikatë për Shtyp e Presidentit të IRJM **Dr. Gjorgje Ivanov, 29 maj 2013** në

<http://www.president.gov.mk/en/media-centre/press-releases/2142.html>

prej tyre Serbia ka refuzuar të marrë pjesë për shkak të prezencës së Kosovës, në gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre Kosova nuk ka marrë pjesë për shkak të fusnotës së vendosur në tabelat me emërtime, por gjithashtu edhe në tri-katër ngjarje për shkak të vonesës në lëshimin e vizave për delegacionin e Kosovës dhe mungesës së buxhetit.<sup>56</sup>

Qeveria e Kosovës raportoi se në një takim të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë, e mbështetur nga DCAF, më 16-18 tetor 2012, me temën ‘Organizatave kriminale të drogës, situata në BE me përqendrim të veçantë në zonën e Ballkanit’, vetëm delegacioni i Kosovës ishte përfaqësuar pa flamur. Gjithashtu edhe në ‘Takimin fillestar të Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare mbi Politikën e Jashtme të Evropës Lindore’, të organizuar nga Parlamenti i Republikës së Kroacisë më 18 dhe 19 tetor, në Zagreb, Kosova nuk ishte ftuar të marrë pjesë.<sup>57</sup>

Në terma të përgjithshme, organizatat rajonale i janë përgjigjur pozitivisht Marrëveshjes.<sup>58</sup> Deri në qershor 2013, nuk janë raportuar ndryshime të mëdha në zbatim.

**Problemet:** Në disa raste Serbia ka lobuar kundër anëtarësimit të Kosovës në disa organizata duke përdorur si arsytim qëndrimin se Kosova po aplikon në më shumë organizata rajonale përtej listës së Cooper-it. Sidoqoftë, marrëveshja nuk përcakton se Kosova është e kufizuar me listën e krijuar nga lehtësuesi i BE-së për Dialogun Teknik, z. Robert Cooper. Siç është thënë nga zyrtari i Qeverisë së Kosovës, Serbia vazhdimisht e minon këtë proces<sup>59</sup> por përfundimisht ata do të lëshojnë pe.<sup>60</sup>

Për më shumë, koordinatori i Qeverisë së Kosovës për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal në përgjithësi ka vërejtur përmirësim në zbatimin e kësaj marrëveshje.<sup>61</sup>

Përfundimisht, zbatimi dhe problemet lidhur me marrëveshjen mbesin si më kundërthënëse për delegacionin e Kosovës. Partitë opozitare, shoqëria civile dhe mediet në Kosovë akuzuan Qeverinë e Kosovës se po pranon të dalloj Kosovën nga shtetet tjera të përfaqësuara (duke pranuar të përdor një yll – dhe fusnotën e kontestuar nga Kosova- pranë emrit të Kosovës) duke vënë kështu në pikëpyetje shtetësinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës edhe vetë hezitonte të pranojë marrëveshjen në fillim. Sidoqoftë, Kosova e pranoi marrëveshjen vetëm pasi u bind nga SHBA-ja ta bëjë këtë. Në përgjithësi, marrëveshja është parë si një hap prapa meqë pranonte se statusi politik i Kosovës është ende i pazgjidhur. Dykuptimësia e detajeve të marrëveshjes vuri Serbinë në një pozitë goxha të çuditshme, ku në disa raste ata do të refuzonin të merrnin pjesë ose ishin detyruar të braktisnin takimet për shkak të

<sup>56</sup> Intervistë me Koordinatorin e QeK për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, 8 maj 2013.

<sup>57</sup> Gjendja e tanishme e zbatimit të marrëveshjeve të Dialogut Teknik, shtator 2012 – nëntor 2012, Raportuar nga autoritetet e Kosovës, 16 nëntor 2012.

<sup>58</sup> Gjendja e tanishme në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut Teknik, shkurt 2012 – gusht 2012, Raportuar nga autoritetet e Kosovës, 23 gusht 2012.

<sup>59</sup> Kosova ka aplikuar të bëhet anëtare e MARRI (Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë). Ministria e Punëve të Brendshme është duke e koordinuar procesin duke i dërguar kërkesën Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bosnje Hercegovinës. Lidhur me këtë çështje është mbajtur një takim në maj 2013. Serbia po kundërshton gjithashtu me arsytimin se kjo organizatë rajonale nuk është e rreshtuar në Listën e Cooper-it. Gjithashtu, Serbia ka thënë arsytime të ngjashme për anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në RESPA (një organizatë ndërkombëtare të cilës i është besuar misioni i ndërtimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e administratës publike në Ballkanin Perëndimor). Intervistë e KIPRED me Koordinatorin e QeK për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, 8 maj 2013

<sup>60</sup> Ibid.

<sup>61</sup> Intervistë me Koordinatorin e QeK për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, 8 maj 2013

faktit se Kosova po përfaqësohej vetëm me një yll, dhe jo tërë tekstin e fusnotës. Megjithatë, krahasuar me Kosovën, zbatimi i kësaj marrëveshjeje ishte më pak i diskutueshëm në Serbi.

#### 7. Menaxhimi i Integruar i Kufijve/Kufijve administrative (IBM)

Marrëveshja: Në parim kjo marrëveshje u arrit gjatë dy raundeve të fundit të dialogut teknik të mbajtura në dhjetor 2011 por zbatimi i saj filloi vetëm një vit më vonë, në dhjetor 2012, pasi filloi dialogu politik në mes të dy kryeministrave, të Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja përcakton që dy shtetet duhet të instalojnë pika të përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta në të gjitha kalimet kufitare (gjashtë në tërësi), që janë të përcaktuara bashkërisht në mënyrë që të ushtrojnë bashkëpunimin siç është definuar me ligjin e BE-së. Asnjëra nga palët nuk do të shpalojë ndonjë simbol të juridiksionit të tyre përkatës në zonat e përbashkëta të IBM-së.

Zbatimi dhe problemet: Marrëveshja përmban nënshkrimin e një protokollit teknik nga të dyja palët, Kosova dhe Serbia me BE-në që do të sigurojë detajet teknike të zbatimit. Protokollit Teknik u nënshkrua nga ana e Kosovës më 29 shkurt 2012. Sidoqoftë, zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Serbi gjatë majit 2012 ndaluan zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Më 24 shtator 2012, qeveria serbe i dërgoi një letër BE-së, lidhur me 'kontrollin e përbashkët të kalimeve administrative me Kosovën' duke konfirmuar se qeveria e re do ta zbatojë marrëveshjen e IBM-së.

##### a. IBM-ja dhe dialogu politik

Qeveria e re nacionaliste në Serbi garantoj se do të zbatojë të gjitha marrëveshjet e arritura më parë në dialogun me Kosovën. Sidoqoftë, zbatimi i IBM-së ende po vazhdon të mbetet prapa sepse zbatimi do të zhvuloste ndikimin e Beogradit në veri dhe do të krijonte terren për integrimin e pjesës veriore të Kosovës në pajtim me Planin e Ahtisaarit. Përveç faktit që Serbia po e shtynte zbatimin e kësaj marrëveshjeje, garantuesit (BE dhe SHBA) përdorën një qasje të butë kur i kërkuan Serbisë që ta zbatojë atë. Kjo vonesë i mundësoi Serbisë që ta ri-negociojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje të arritur gjatë dialogut "teknik". Marrëveshja u ri-negocioi në mes të dy Kryeministrave, e cila përfshiu edhe marrëveshjet për arkëtimin e të hyrave doganore në kalimin kufitar në veri.

Në një takim ndërmjet Kryeministrave Thaçi dhe Dacic, i mbajtur më 4 dhjetor 2012, u arrit një marrëveshje që tri kalimet e para të përkohshme do të themeloheshin në Merdarë në anën e Kosovës dhe në Rudnicë e Konçul në anën e Serbisë. Vendkalimi i përkohshëm i IBM-së në Bërnjak (territori i Kosovës) u operacionalizua tri javë më vonë (31 dhjetor 2012) për shkak të "nevojës së konsultimeve me komunitetin vendor".<sup>62</sup>

Nga pikëvështrimi i BE-së, zbatimi i marrëveshjes po shkonte më mirë se sa ishte pritur. Në të vërtetë, derisa zbatimi po shkonte në mënyrë të patrazuar në kalimet në Merdarë dhe Konçul, në dy kalimet në pjesën veriore të Kosovës ka ende vështirësi sa i përket zbatimit. Kjo marrëveshje ishte njëra nga më të vështirat për tu zbatuar për Serbinë. Derisa pala kosovare e paraqiste këtë marrëveshje si njohje nga Serbia të kufirit mes Kosovës e Serbisë, Serbia duhej të bindte opinionin e saj publik se marrëveshja nuk njeht kufirin mes Kosovës e Serbisë. Serbia pohon se marrëveshja nuk e përmend fjalën "Kufi" dhe në vend të saj ajo përdor fjalën "Kufi administrativ" dhe kontesti mes Kosovës e Serbisë vazhdon. Kjo ndihmohet nga fakti se vetë marrëveshja përdor vetëm akronimin IBM, duke lejuar interpretime të ndryshme nga secila palë.

<sup>62</sup> Gjendja aktuale në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut Teknik, shtator 2012 – nëntor 2012, Raportuar nga autoritetet e Kosovës, 16 nëntor 2012.

Gjithashtu zbatimi i marrëveshjes ishte i vështirë për shkak të rezistencës së qytetarëve serbë të Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, të cilët refuzojnë të njohin autoritetin e Prishtinës dhe vetëm autoritetin e Beogradit e njohin si të tyrin. Krijimi i pikave të IBM-së kërkon që të gjitha mallrat që hyjnë në Kosovë nga kjo pjesë t'i nënshtrohen doganës siç kërkohet me ligjet e Kosovës, të cilët qytetarët serbë të Kosovës refuzojnë t'i pranojnë dhe të paguajnë doganë që shkon në buxhetin e Kosovës. Një zgjidhje për këtë kontest thuhet se është gjetur në takimin e fundit në mes të Kryeministrit të Kosovës dhe Serbisë, i mbajtur më 17 janar 2013, ndonëse detajet e marrëveshjes nuk janë të njohura ende. Të dyja anët, Kosova dhe Serbia, dhanë shpjegime kundërthënëse për çka janë pajtuar.